Tegelat e qepjes tek faqja, mbrapshtinave, filetave dhe sipërines së vesheve realizohen me pe me Nm 40/3 dhe Nm 30/3. Tegelat duhet të jenë 1-2 mm larg buzëve dhe me hap 3-4 hapa në 1 cm. Mbyllja e faqes realizohet me makine dygjilpershe ku distanca ndërmjet tegelave paralel duhet të jetë 3-4 mm. Për të realizuar një forcim sa më të fortë gjatë mbylljes së sipërines tegelat qepen dyfish. Tegelat duhet të jenë të rregullt, të forta, pa vende të shqepura dhe të forcuar në fund.

Tabani prej soletit të lekure duhet të jetë i barazuar dhe i zmeriluar në të dy anët. Tabanit nga poshtë duke filluar që nga pjesa e rrumbullakët të fundit të thembrës i fiksohet kamareta. Kamareta në të gjithë gjatësinë e saj duhet të mbulohet me karton fiber të presuar me gjatësi 14-15 cm dhe gjerësi 6.4- 6.6 cm.

Ne fazën e dytë: gjysemprodukti i perfunduar (pjesa e sipërme e kepuces) kalon në procesin e dhënies së formës së kepuces me anë të fiksimit nëpër kalëp të gatshëm. Gjatë këtij procesi bëhet njekohesisht dhe vendosja e tabanit në mënyrë të tillë që kamareta të perputhet plotësisht me boshllëkun që krijohet nga trashësia e faqes. Gjysemprodukti i nënshtrohet procesit të zmerimit dhe barazimit të pjesës së poshtme gjatë të cilit duhet bërë kujdes që të eliminohen të gjitha palat, kanalet ose të ngriturat sidomos në majë, në thember dhe në pjesën qendrore të jashtme dhe të brendshme të tij duke bërë një barazim sa më të mirë të sipërfaqes së pjesëve të kthyera të lekures. Zmerilimi dhe barazimi shumë i mirë bëhet mundur realizimin me çilesi të lartë të procesit të fiksimit të fiapës me tabanin.

Fiapa fiksohet me tabanin dhe pjesën e poshtme të gjysemproduktit me ngjitje dhe me qepje. Për ngjitjen përdoret material ngjites me një komponent. Materiali ngjites duhet të perhapet si në të gjithë sipërfaqen e sipërme të fiapës ashtu dhe në të gjithë sipërfaqen e pjesës së poshtme të gjysemproduktit. Ngjitja duhet të kryhet në të gjithë sipërfaqen e fiapës dhe pjesës së poshtme të gjysemproduktit. Ngjitja duhet të jetë shumë e mirë. Rezistenca e ngjitjes së fiapës me tabanin duhet të jetë e lartë. Qepja e fiapës me tabanin bëhet brenda dhe jashtë dhe kryhet me makine. Për qepje përdoret pe sintetik me fortesë 38 kG me hap të tegelit 4 hapa në 3 cm. Tegeli duhet të jetë shumë i fortë dhe nuk duhet të dalë jashtë buzëve të fiapës ose të tabanit. Kanali i fiapës duhet të jetë me gjerësi 2 mm dhe thellesi 1.5 mm. Distanca nga kundi i prerjes së fiapës në mesin e kanalit duhet të jetë 10-12 mm.

Sholla fiksohet me fiapën me ngjitje duke përdorur material ngjites me dy komponente. Materiali ngjites duhet të perhapet si në të gjithë sipërfaqen e poshtme të fiapës ashtu dhe në të gjithë sipërfaqen e pjesës së sipërme të shollës. Ngjitja duhet të

kryhet ne te gjithë siperfaqen e sholles dhe fiapes dhe te jete shume e mire.Rezistenca e ngjitjes se fiapes me tabanin duhet te jete mbi **20 N**.

Ne brendesi te kepuces siper te gjithë siperfaqes se tabanit me ngjitje dhe e shtrire mire vendoset si shtroje astar meshini me trashesi **0.9-1.2mm**.Midis asatrit dhe tabanit ne qender te pjeses ku vendoset dhe qendron shputa e kembes duhet te jete fiksuar me ngjitje material i bute (sfungjer i presuar). Ne perfundim behet zmerilimi dhe barazimi i buzeve te bashkimit te fiapes me shollen,perpunimet perfundimtare te rifinitures dhe lysterja me boje.

KLASIFIKIMI

a.Numrat e kepuceve do te jene sipas Nr 39 deri 44.

Sasia sipas numerave do te behet mbi bazen e kerkesave te Gardes me lidhjen e kontrates me prodhuesin.

b. Kepucet prodhohen me 2 fraksione me gjatesi dhe gjeresi te ndryshme sipas numrave.

Permasat e meposhteme i referohen kepuces Nr.41.

Fraksioni i I-re

gjatesia	273 mm
gjeresia	245 mm

Fraksioni i II-te

275 mm
255 mm

Toleranca per gjatesine eshte 6.67 mm dhe vlen per te gjitha gjatesite.

Lartesia e qafes se kepuces e matur nga jashte mbi xhiron e gomes duke iu referuar numrit **41** duhet te jete : $41 + 24 = 65 \text{ mm} \pm 1 \text{ mm}$.

Lartesia e qafes se kepuces e matur nga brenda mbi astarin e shtrojes duke iu referuar numrit **41** duhet te jete : $41 + 17 = 58 \text{ mm} \pm 1 \text{ mm}$.

Koeficientet **24 mm** dhe **17 mm** vlejne per te gjithë numrat e kepuceve.

Per kontrollin cilesor ne procesin e prodhimit

Per sigurimin dhe garantimin e cilesise gjate procesit te prodhimit te artikullit "Kepuce gjysma uniforme dimri", specialiste te fushes te Gardes se Republikes, me autorizim nga titullari, kane te drejte te ndjekin e te kontrollojne procesin e prodhimit ne fabriken prodhuese ne te cilen kryhet prodhimi i ketij artikulli. Kontrolli cilesor ne procesin e prodhimit (kur kryhet) do te perfshije verifikimin cilesor te kerkesave teknike te artikullit "Kepuce gjysma uniforme dimri" matjet dhe provat fizike, analizen e lendes se I-re dhe materialeve ndihmese te siguruara nga prodhuesi per te prodhuar gjithë sasine e percaktuar ne kontraten e lidhur midis paleve, duke bere krahasimin e rezultateve te tyre ne labororet e lekure-kepuces, me kerkesat e ketij Specifikimi

Teknik, kampionin dhe modelin e miratuar. Ne momentin që konstatohet se ndonjë fazë e procesit të prodhimit nuk garanton cilësinë perfundimtare të produktit të gatshëm “Kepuce gjysma uniforme dimri”, ndalon procesin e prodhimit duke mbajtur Proces-verbalin perkates.

Kontrolli cilësor do të kryhet në procesin e prodhimit për të siguruar cilësinë e prodhimit të sasise së kontraktuar, ndërsa kolaudimi i mallit si proces i pavarur do të bëhet mbas dorezimit të sasise së kontraktuar në magazinën e porositësit.

Amballazhimi, marketimi dhe etiketimi.

Kepucet të jenë të ambalazhuara në kuti kartoni 1 (një) pale në çdo kuti.

Çdo kuti nga ana e jashtme të ketë numrin e kepuceve.

Artikulli “Kepuce gjysma uniforme dimri” marketohet në anë në astarin e brendshëm afër fundit të lartësisë së qafes ku shenohet qartë numri i kepuces. Numri i kepuces duhet të jetë i shënuar në mënyrë të dukshme dhe poshtë shollës së gomes.

Garancia. Garancia e kepuceve në përdorim të jetë 1 vit. Furnizuesi merr përsipër zëvendësimin e kepuceve të dëmtuara gjatë përdorimit brenda afatit të garancisë, si dhe për defekte që vijnë si rrjedhojë e procesit teknologjik.

Kolaudimi, marrja në dorëzim

Pranimi i të gjithë sasise të artikullit “Kepuce gjysma uniforme dimri” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e porositësit do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të meren gjatë procesit të kolaudimit për të gjithë sasine e produktit të gatshëm.

Teknikisht kolaudimi do të bëhet mbi bazë të Fletë analizave laboratorike të kryera për lëndën e parë dhe produktin e gatshëm, në Laboratorin e Akredituar të lekure-kepuces, si dhe kryerjen direkt të matjeve dhe provave fizike të mostrave përfaqësuese të sasise të mallit të dorëzuar, dhe krahasimin e këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik dhe modelit të miratuar.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij specifikimi teknik.

Shënim:Ky specifikim teknik, kampioni, modeli dhe ngjyra e artikullit “Kepuce gjysma uniforme dimri” për punonjësit janë prone e Gardes të Republikës, dhe për nga qellimi i përdorimit ato i perkasin vetëm strukturave të saj. Nuk lejohet shumfishimi dhe realizimi i këtij Specifikimi teknik, modelit dhe ngjyrës së artikullit “Kepuce gjysma uniforme dimri”.

ARTIKULLI : Këpuce gjysma uniforme vere





Specifikimi teknik i artikullit “Kepuce gjysma uniforme vere” per punonjesit e punonjeset e Gardes te Republikes eshte hartuar ne perputhje me **VKM Nr. 136 dt.11.02.2009**.

Ky specifikim teknik ne menyre te detajuar paraqet kerkesat themelore teknike te domosdoshme per prodhimin ne linje industriale mbi bazen e proceseve teknologjike te artikullit “Kepuce gjysma uniforme vere”. Ne kete specifikim teknik percaktohen gjithashtu dhe kerkesat teknike te aksesoreve qe shoqerojne artikullin “Kepuce gjysma uniforme vere ” si produkt te gatshem .

Te gjitha percaktimet teknike te ketij specifikimi teknik duhen te zbatohen detyrimisht sakte nga prodhuesi.

Per procedure vleresimi dhe miratimi nga perdoruesi, ofertuesi eshte i detyruar te paraqese si oferte teknike te realizuar sipas kerkesave te ketij specifikimi teknik:

- a. 1(nje) pale kepuce Nr 42 te qepura me penj te bardhe .
mostra duhet te kete te trupezuar vulen dhe etiketen orgjinale te fabrikes prodhuese.
- b. 1 (nje) cope lekure natyrale boks vici me permasa 30 x 30 cm, me vule dhe etikete orgjinale te ofertuesit, te trupezuar.
- c. 1(nje) cope astar meshini dhie, me permasa 30 x 30 cm me vule dhe etikete orgjinale te ofertuesit te trupezuar.

d. Flete analize laboratorike të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës të pare lekure natyrale boks vici dhe astarit meshin dhie.

Lekura e mostres, lëndës së pare dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Mungesa e mostres, lëndës pare dhe flete analizes që shoqëron ato është kusht skualifikues.

LENDET E PARA E NDIHMESE :

A. Pjesa e sipërme.

- Lekure natyrale (boks) viçi, cilësia e pare: sipas **(STASH.1143-89)**
 - ngjyra e zeze
 - cngjyrosja > nota 4
 - trashësia 1.1 – 1.4 mm
 - yndyra 4 -7 %
 - rezistenca ndaj plasjes së faqes > 1.8 kG/mm²
 - rezistenca ndaj keputjes së faqes > 2.0 kG/mm²
 - zgjatimi në ngarkesë 15 – 25 %
 - qëndrueshmëria deri në keputje 40 – 60 %
 - penetrimi i ujit gjendje statike > 40 minuta
 - rregjia 0 % rregjia shumë e mirë
- Meshine dhie – cilësia e pare për astarin e faqes, lapetes, mbrapshtines dhe shtrojes me trashësi 0.6 – 1 mm. **(STASH -1144-89)**
 - yndyra 4 -7 %
 - rezistenca ndaj plasjes së faqes > 1.3 kG/mm²
 - rezistenca ndaj keputjes së faqes > 1.5 kG/mm²
 - zgjatimi në ngarkesë 15 – 30 %
 - rregjia 0 % rregjia shumë e mirë
- **Suprina është dy copshe, në suprinë 6cm në thellesi nga maja, behet bashkimi i dy copave, e cila mbyllet me një qepje dy tegelesh për zbukurim, kepuca përpara vjen me maje jo shumë të theksuar.**
- Penje-Sintetike me fortësi 38 kg(4hapa në 3 cm) për qepjen brenda jashtë të fjaqes me tabanin,
- penj sintetike me ngjyrë të zeze me rezistencë mbi 9 kg Nr 40/3 për masurën dhe 30/3 për qepjen e suprinës(veshet,mbrapshtines, filetove dhe tegelave të tjera të faqes së kepuces).
- Bombe material termoplastik me trashësi jo më pak se 1 mm.
- Forte material termoplastik me trashësi jo më pak se 1 mm .

B:Pjesa e poshtme.

- Sholle gome kompakte e presuar (pjesa e poshtme e kepuces) me trashësi 5–6

mm nga e cila 1-1.2 mm të jete trashesia e kanaleve ose e luleve(reliev kunder rreshqitjes).

- Taban- Solete (lekure natyrale) me trashesi 2+/-05 mm.
- Fjap gome e presuar me trashesi 3+/-05 mm.
- Xhiro gome e presuar me pjerresi konike e gjeresi 17-19 mm.
- Taka gome e presuar me lartesi 2.8 -3 cm(se bashku me gomen e fjapen që shoqerohet me xhiro).
- Ngjites 1 komponent për ngjitjen e fjapës me tabanin dhe ngjites 2 komponente për ngjitjen e fjapës me shollen.Ngjitja të jete shume e mire.

Treguesit cilesore të pjesës së poshtme :

- Fortesia në grade shore për “Shoje të presuar” të jete 73+/-3
- Fortesia në grade shore për “Fiap të presuar” të jete 80+/-5.

Menyra e montimit: Detajet e pjesës së poshtme dhe pjesës së sipërme të kepuces,montohen në kallop sipas procesit teknologjik,me qepje e ngjitje.

Menyra e lidhjes së kepuces: me lidhese të zakonshme me gjatesi të pranueshme dhe me 4 (kater) çifte vrimash me syze metalike në të dyja anet.

KLASIFIKIMI

a.Numrat e kepuceve do të jenë sipas sasive të percaktuara në tabelat e mëposhtme :

Per meshkuj

Numrat e kepuceve do të jenë nga Nr. 39 – 45.

Sasia sipas numerave do të behet mbi bazën e kërkesave të Gardes, me lidhjen e kontratës me prodhuesin.

b. Kepucet prodhohen me 2 fraksione me gjatesi dhe gjeresi të ndryshme sipas numrave.

Permasat e mëposhtme i referohen kepuces Nr.41

Fraksioni i I-re

gjatesia 273 mm

gjeresia 245 mm

Fraksioni i II-te

275 mm

255 mm

Toleranca për gjatësinë është **6.67 mm** dhe vlen për të gjitha gjatësitë.

Lartësia e qafës së kepuces e matur nga jashtë mbi xhiron e gomes duke iu referuar numrit **41** duhet të jete : $41 + 24 = 65 \text{ mm} \pm 1 \text{ mm}$.

Lartësia e qafës së kepuces e matur nga brenda mbi astarin e shtrojes duke iu referuar numrit **41** duhet të jete : $41 + 17 = 58 \text{ mm} \pm 1 \text{ mm}$.

Koeficientet **24 mm** dhe **17 mm** vlejne për të gjithë numrat e kepuceve.

Per kontrollin cilesor ne procesin e prodhimit

Për sigurimin dhe garantimin e cilësise gjatë procesit të prodhimit të artikullit “Kepuce

gjysma uniforme vere”, specialiste të fushës të Gardes së Republikës, me autorizim nga titullari, kanë të drejtë të ndjekin e të kontrollojnë procesin e prodhimit në fabriken prodhuese në të cilën kryhet prodhimi i këtij artikulli. Kontrolli çilesor në procesin e prodhimit (kur kryhet) do të përfshijë verifikimin çilesor të kërkesave teknike të artikullit “Kepuce gjysma uniforme vere” matjet dhe provat fizike, analizën e lëndës së lirë dhe materialeve ndihmëse të siguruar nga prodhuesi për të prodhuar gjithë sasinë e përcaktuar në kontratën e lidhur midis paleve, duke bërë krahasimin e rezultateve të tyre në laboratorët e lekure-kepuces, me kërkesat e këtij Specifikimi Teknik, kampionin dhe modelin e miratuar. Në momentin që konstatohet se ndonjë fazë e procesit të prodhimit nuk garanton çilësine të mjaftueshme të produktit të gatshëm “Kepuce gjysma uniforme vere”, ndalon procesin e prodhimit duke mbajtur Proces-verbalin përkatës.

Kontrolli çilesor do të kryhet në procesin e prodhimit për të siguruar çilësine e prodhimit të sasisë së kontraktuar, ndërsa kolaudimi i mallit si proces i pavarur do të bëhet mbas dorezimit të sasisë së kontraktuar në magazinën e porositësit.

Amballazhimi, marketimi dhe etiketimi.

Kepucet të jenë të ambalazhuara në kuti kartoni 1 (një) pale në çdo kuti.

Çdo kuti nga ana e jashtme të ketë numrin e kepuceve.

Artikulli “Kepuce gjysma uniforme vere” marketohet në anë të astarin të brendshëm afër fundit të lartësive të qafës ku shënohet qartë numri i kepuces dhe data e prodhimit. Numri i kepuces duhet të jetë i shënuar në mënyrë të dukshme dhe poshtë shollës së gomes.

Garancia. Garancia e kepuceve në përdorim të jetë 1 vit. Furnizuesi merr përsipër zëvendësimin e kepuceve të dëmtuara gjatë përdorimit brenda afatit të garancisë për defekte që vijnë si rrjedhojë e procesit teknologjik, por jo të keqpërdorimit.

Kolaudimi, marrja në dorëzim

Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit “Kepuce gjysma uniforme vere” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e porositësit do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të meren gjatë procesit të kolaudimit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm.

Teknikisht kolaudimi do të bëhet mbi bazë të Fletës analize laboratorike të kryera për lëndën e parë dhe produktin e gatshëm, në Laboratorët e Akredituar të lekure-kepuces, si dhe kryerjen direkt të matjeve dhe provave fizike të mostrave përfaqësuese të sasisë të mallit të dorëzuar, dhe krahasimin e këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik dhe modelit të miratuar.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij specifikimi teknik.

Shënim: Ky specifikim teknik, kampioni, modeli dhe ngjyra e artikullit “Kepuce gjysma uniforme vere” për punonjësit janë prona e Gardes së Republikës, dhe për nga

qellimi i përdorimit ato i perkasin vetem strukturave te saj. Nuk lejohet shumfishimi dhe realizimi i ketij Specifikimi teknik,kampionit, modelit dhe ngjyres se artikullit “Këpuce gjysma uniforme vere”.

ARTIKULLI : Këpuce tip atlete

1. MATERIALET

a. Materialet bazë që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit *këpuce tip atlete për strukturat e veçanta të Gardes* duhet të jenë të cilësisë së parë me këto të dhëna teknike:

Faqet dhe ndërfutjet

Përbërja	faqet	lëkurë natyrale e butë,
ndërfutjet	100 % Poliamid	
Ngjyra	faqet	e zezë, e njëtrajtshme, me pak shkëlqim.
ndërfutjet		
Trashësia	faqet	2 mm
Regjja e lëkurës	kromike	
Përpunimi	Lëkurë të plota, material hidrofobik	
Thurja	Ndërfutjet	Diagonale
Numri metrik	Ndërfutjet	1000D
Qëndrueshmëria e ngjyrës (ndërfutjet)	nota 4 - 5	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV) (ndërfutjet)	Nota 7 - 8	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri maksimale.
Depërtueshmëria e ujit (ndërfutjet)	mbi 20, 000 mm	Mbrojtje shumë e mirë
Aftësia ajërosëse e tekstilit (ndërfutjet)	mbi 15,000 gr	Ajërosje shumë të mirë
Qëndrueshmëria në fërkim (ndërfutjet)	mbi 20000 cikle	
Rezistenca e ngjyrës në lëvizje (matur me flaxometer)	faqet	12000
Qëndrueshmëria deri në këputje	faqet	Deri 70%
Penetrimi i ujit në gjendje statike	faqet dhe ndërfutjet	jo më pak se 240/minutë
Plasja e faqes në palosje katërshe	Nuk lejohet	
Sholla		
Përbërja	gomë e shkrirë e cilësisë së parë	

		(Poliuretan)	
Ngjyra		e zezë	
Lartësia	Rreth 20 mm tek maja	Rreth 35 mm tek taka	
Sipërfaqja		me relieve kundër rrëshqitjes,	
Forma		unike, një trup bashkë me takën	

Ngjyra e produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i lëkurës dhe i tekstilit të ndërfutjeve, do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra e zezë e lëkurës dhe e ndërfutjeve nuk transferohet tek tekstili i bardhë.

Ndërfutjet gjithashtu duhet t'i nënshtrohen provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV).

Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së lëkurës dhe tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme - nota 4 dhe shumë e qëndrueshme - nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së ndërfutjeve ndaj dritës duhet të jetë: *shumë pak zbehje - nota 7 dhe aspak zbehje - nota 8*.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e materialeve, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

prerja nga ana e mishit që nuk kalon 1/3 e trashësisë,
 gërvishtje mbi faqe,
 dëmtime nga kalbja,
 plasje të faqes nga barazimi,
 plasje e faqes nga palosja katërshe,
 gjurmë damarësh,
 ngjyrim jo i njëjlojtë,
 njolla yndyre, kromi ose ekstrakti,
 gërvishtje ose plagë të shëruara,
 pjesë të dobëta,
 vija majmërie ose rrudha të shtrira në trup e qafë,
 thellime nga rrahja,
 valëzime dhe gropëzime,
 pika ose vrima që vijnë si rezultat i pickimeve të insekteve kur kafsha është e gjallë,
 rrudha nga palosjet në kavaletë,
 shkallëzime nga barazimi
 hollime nga sharrimi,
 oksidime,
 porozitet,
 dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të këpucës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesoret që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *këpucë tip athlete për strukturat e veçanta të Gardes*:

Materialet për shtrojën:

Karton kompakt i presuar	Trashësia	1.9-2 mm
Përbërja	Celulozë	
Karton fibër i presuar	Përmasat	14 - 15 cm
Gjerësia	6.4-6.5 cm,	
Forma	Sipas tabanit	
Material për pjesën e shtrojës.	Përbërja	Sfungjer i hollë (memory foam)
Trashësia	11 mm në pjesën e thembrës 4 mm në pjesën e majës	
Kamaretë metalike	Përbërja	shirit çeliku
Modeli	i kanalizuar me nervaturë	
Përmasa	14 - 15 cm	
Gjerësia	8-10mm	
Përforcues:		
Material termoplastik (forti)	Trashësia	1.4mm ± 0.1mm
Material termoplastik (bombeja) që nuk thyhet	Trashësia	1.2mm ± 0.1mm
Material përforcues për pjesën e vrimave tek veshët		
Material prej fletë metalike të presuar, elastike, jomagnetike për majën e këpucës	Trashësia	0.8 mm
Përforcues i brendshëm	Përbërja	sintetike
Trashësia	1.4 mm	
Astari i faqeve		
Tekstil i butë i veçantë me aftësi ajërosëse shumë të mira dhe veti antibakteriale		
Astari i shtrojës		
Lëkurë e cilësisë së parë	Trashësia	0.9 mm
Membrana		
Tekstil	Thurja	rrjetë
Përmbajtja	Polytetrafluoretilene (ePTFE)	
Aftësitë		
e papërshkueshëm nga uji		
kundra erës		
ajrosieje e lartë		

Lidhëset:		
Lidhëse tubolare me ekstremitete plastike,	Ngjyra	e zezë
Thurrrja	gërshet (që nuk shthuren),	
Përbërja	100% poliestër	
Gjatësia	rreth 130 cm.	
Materiale të tjerë:		
Syza për vrimat e lidhëseve.	5 çifte për këpucë	
Përbërja	Metalike	
Solucion lyerje kundra ujit për fortin dhe bombenë		
Sfungjer për qafën e këpucës	Trashësi	6 mm
Sfungjer për mbushjen e lapetës	Trashësi	3 mm
Etiketa:		
Etiketat prej tekstili në të cilat të paraqiten të dhënat e kompanisë prodhuese, masa etj		
Fijet:		
Fill për qepjen e lëkurës	Përbërja	100 % najlon
Hollësi	për faqet e këpucës	Nm 30/3 tex
për astar	Nm 40/3 tex	
Qendrueshmëria	mbi 9 kg.	
Ngjyra	në tonalitet me këpucën	
Fill për tegelat qepës "blake"	Përbërja	100 % najlon
Ngjyra	në tonalitet me këpucën	
Ngjitësi:		
Ngjitësi që do të përdoret duhet të jetë i cilësisë së parë, jo dëmtues dhe të krijojë një ngjitje shumë cilësore, rezistente në mosshqitje, për aq kohë që janë në përdorim këpucët.		

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli këpucë tip atlete për strukturat e veçanta të Gardes do të porositet dhe do të prodhohet në sasinë e numerat sipas kërkesave të Gardes, me lidhjen e kontratës me prodhuesi

Si bazë do të merren përmasat e Nr.41 me të dhëna si më poshtë;

Gjatësia e kallëpit 275 mm

Gjerësia 255 mm

Lartësia e qafës së këpucës e matur mbi xhiron e gomës duhet të jetë 120 mm ± 4 mm.

Toleranca për gjatësinë është ± 6.67 mm dhe vlen për të gjitha gjatësitë. Ndërsa për gjerësinë në gishta dhe në trinë tolerancat janë ± 5 mm për numrat e tjerë.

3. NGJYRA

Këpucët dhe elementët e tjerë duhet të kenë ngjyrë të zezë.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *këpucë tip atlete për strukturat e veçanta të Gardes*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën.

Prerja

Procesi i prerjes duhet të bëhet me shumë kujdes për një shfrytëzim optimal të materialit. Buzët e detajeve të prera duhet të jenë të pastra sidomos në pjesët e harkuara. Prerja e lëndëve të para dhe ndihmëse ka të bëjë me prerjen me tranxhë sipas formave të përgatitura të materialeve që nevojiten për ndërtimin e këpucës. Këpucët e një pale duhet të priten nga e njëjta lëkurë për të shmangur tonalitetet në ngjyrë.

Prerjes në tranxhë sipas formave iu nënshtrohet lëkura, bombeja dhe forti termoplastik, kartoni dhe sholla.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e këpucës të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Proçesi i prodhimit

Proçesi i prodhimit të këpucës ka të bëjë me qepjen dhe montimin e pjesëve përbërëse të këpucës sipas një procesi linear të përcaktuar. Ky proces ndahet në dy faza kryesore.

Faza e parë është përgatitja e pjesës së sipërme të këpuces gjatë të cilës realizohet bashkimi dhe qepja e pjesëve përbërëse prej lëkure së bashku me astarin, fiksimi i bombës dhe fortit termoplastik si dhe fiksimi i kamaretës së celikut tek tabani.

Faza e dytë realizon dhënien e formës së pjesës së sipërme të këpucës me anë të presimit në kallëp, fiksimin e tabanit si dhe montimin e shollës. Punimet përfundimtare dhe lyerja me bojë janë fazat e fundit. Midis proceseve të ndërmjetme të kësaj faze për një përpunim sa më të mirë në përputhje me kërkesat teknologjike, gjysëmprodukti kalon dhe i nënshtrohet proceseve termike në furrën e ngrohjes.

5. NDËRTIMI I KËPUCËS

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të këpucës.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.





këpucë tip atlete për strukturat e veçanta të Gardes duhet të jenë me elemente lëkure, me ndërfitje prej tekstili poliamid dhe gomë. Këpucët duhet të jenë të tipit sport, me qafë deri te kavilja, me pesë vrima, për përdorim gjatë sezonit të verës për punonjësit që shërbejnë në strukturat e veçanta të Gardes.

Pjesët përbërëse të këpucës:

Faqet

Pjesa e sipërme e qafës mbrapa (veshët)

Gjuhëza (llapa)

Vrimat dhe lidhëset

Maja

Përforcues i brendshëm

Astar i brendshëm

Kupa e gishtave (bombeja) dhe kupa e thembrës (forti)

Shtroja

Sholla prej gome

PJESA E SIPËRME E KËPUCËS

DETAJET, LLOJI I MATERIALIT DHE PUNIMI

FAQET

Lloji i materialit i përdorur për pjesën e sipërme të përparme të këpucës verore tip atlete duhet të jetë prej lëkure cilësi e parë, me ngjyrë të zezë, me trashësi 2 mm. Lëkura duhet të jetë reflektuese ndaj diellit duke mbajtur lëkurën dhe këmbën të freskët. Faqja e përparme e sipërme bashkohet me faqet anësore prej tekstili poliamid me tegel qepës dygjilpërësh. Ndërfutjet prej tekstili poliamid duhet të bashkohen me thembrën me anë të tegelit qepës të brendshëm.

Pjesa qendrore duhet të bashkohet me faqen e përparme me anë të tegelit qepës dy gjilpërësh të poshtëm. Në lartësinë e kaviljes së këmbës të realizuar me material lëkure duhen montuar dhe shtesat (ndërfutje) me material tekstil poliamid me anë të tegelit qepës dy gjilpërësh.

Faqja e thembrës duhet të realizohet në pjesën e pasme të këpucës me dy pjesë, të

modeluara. Pjesa e poshtme e realizuar me të njëjtën lëkurë si e faqeve, pritët në formë harku sipas formës së thembrës, e cila bashkohet me pjesën e pasme të faqes dhe thembrën e sipërme nëpërmjet tegelit qepës perimetral dygjilpërësh. Pjesa e sipërme gjithashtu e realizuar me material lëkure, bashkohet me faqet dhe ndërfitjet prej tekstili poliamid nëpërmjet tegelit qepës dygjilpërësh perimetral. Faqja e thembrës ka lartësi rreth 6 cm. Pjesa e sipërme e faqes së thembrës përfundon me një shirit të gjerë në formë yliku, prej lëkurë për të bërë të mundur lehtësimin e veshjes së këpucës.

Faqet bashkohen me shtrojën dhe shollën nëpërmjet procesit të ngjitjes dhe tegelave.

PJESA E SIPËRME E QAFËS

Bordura e sipërme e këpucës është realizuar me lëkurë e cilësisë më të mirë, me ngjyrë të zezë, me trashësi rreth 2 mm dhe lartësi rreth 2 cm. Buzët e lira të veshëve, duhet të përshkohen nga një tegel linear perimetral një gjilpërësh që shërben edhe për qepjen e lëkurës me astarin e brendshëm të këpucës. Astari dhe lëkura duhet të jenë të palosur dhe të qepur me tegela të fshehtë tek buzët e lira të qafës dhe veshëve për të mbrojtur lëkurën e këmbës nga gërvishtjet

Bordura është tërësisht e mbushur me shtresë sfungjeri dhe ekstremitetet e saj bashkohen me dy pjesët anësore. Në sipërfaqen e bordurës, janë gjithësej 12 vrima, për ajërosje. Pas tegelit qepës të faqeve dhe të astarit duhet të bëhet aplikimi i vrimave.

GJUHËZA (LLAPA)

Faqja e përparme përfundon në afërsi të qafës së këpucës me aplikimin e një gjuhëze e cila qepet me anë të tegelit qepës dy gjilpërësh, në brendësi të faqes së sipërme. Gjuhëza duhet të jetë prej tekstili poliamid dhe është e ndërtuar me dy pjesë. Pjesa e poshtme që është vazhdimi i astarit të bordurave me tegel syzator përgjatë shtesave anësore (lëkurë), me tegel qepës të ndërmjetëm përforcues dhe pjesa e sipërme me kënde të rrumbullakosura, e montuar me astarin e brendshëm. Në pjesën rreth majës së jashtme të gjuhëzës duhet të vendoset një mbushje sfungjeri për funksion mbrojtës dhe komoditeti.

Lartësia e këtyre shtesave duhet të jetë e tillë që të garantojë një nivel minimal padepërtueshmërie e barabartë me 75% të lartësisë totale të këpucës, e matur në pjesën e brendshme nga fillimi i shollës deri në pikën më të lartë të faqes.

VRIMAT E KËPUCËS

Në dy pjesët e bordurave të gjuhëzës, janë të montuara aksesoret metalik, 5 çifte për fiksimin e lidhëseve. Distancat e vrimave nga njëra-tjetra duhet të jenë të barazlanguara. (8-9 mm secila vrimë). Tek pjesa e veshit (tek vrimat) vendoset një material përforcues nga ana e brendshme që ruan fortesën e lëkurës kur tërhiqet, në mënyrë që vrimat e lidhësëve të mos çahen edhe nëse tërhiqen fort.

Lidhëset e këpucëve janë me ngjyrë të zezë, të rrumbullakta me fije poliester me gjatësi rreth 130 cm (që nuk shthuren), me ekstremitete plastike.

MAJA E KËPUCËS

Forma e majës së këpucës duhet të jetë e rrumbullakët. Maja duhet të realizohet nga material prej flete metalike të presuar, elastike, jo magnetike, me trashësi 0.8 mm. Kjo shtresë aplikohet në pjesën e përparme nga brenda këpucës ndërmjet astarit dhe faqes


së sipërme të këpucës.

PËRFORCUES I BREND SHËM

Përforcuesi i brendshëm është realizuar prej materiali sintetik me trashësi 1.4 mm. Ai aplikohet në brendësi, në anën e pasme ndërmjet faqes së sipërme dhe astarit të brendshëm.

ASTARI I BREND SHËM

Pjesa e brendshme e këpucës: gjuhëza, faqet anësore dhe thembra janë realizuar me astar prej tekstili të butë. Astari prej tekstili duhet të vendoset nga krahu i kontaktit me këmbën, i bashkuar dhe termosalduar me një shtresë të brendshme membrane të papërshkueshëm nga uji, kundra erës dhe me aftësi ajërosëse shumë të larta. Përmbajta e membranës është: *Polytetrafluoroethylene* (ePTFE). Membrana vendoset mes lekurës së këpucës dhe astarit të brendshëm.



Astari është realizuar me tre pjesë, tredimensionale të cilat bashkohen ndërmjet tyre me anë të tegelit qepës syzator. Ky astar është aplikuar në të gjithë pjesën e brendshme të këpucës duke bërë të mundur totalisht padepërtueshmërinë e ujit në këpucë.

KÛPA E MBRAPME (FORTI) DHE KÛPA E PËRPARME (BOMBE).

Forti duhet të jetë prej materiali termoplastik, që nuk thyhet, me trashësi $1,4 \text{ mm} \pm 0,1 \text{ mm}$. Ai vendoset në pjesën e mbrapme të këpucës. Forti ka formën e këmbës në pjesën e mbrapme dhe krijon një përputhje me të. Forti ngjitet midis pjesës së jashtme dhe të brendshme të mbrapme.

Bombeja duhet të jetë prej material termoplastik, që nuk thyhet, me trashësi $1,2 \text{ mm} \pm 0,1 \text{ mm}$. Ajo vendoset në pjesën e përparme, në majën e këpucës. Bombeja shtrohet midis pjesës së jashtme dhe të brendshme të përparme. Bombeja dhe forti e marrin këtë formë gjatë punimit me nxehtësi në kallëpe me temperaturë të posaçme (vetëm për këto pjesë të këpucës). Bombeja dhe forti duhet të lyhen me solucion kundra ujit.

SHTROJA

Shtroja duhet të realizohet me material shumëstresor me anë të procesit të ngjitjes dhe qepjes dhe është e përbërë nga:

Tabani i cili duhet të jetë prej celuloze (tip kartoni shumëstresor) të përforcuar e cilësisë së lartë, rezistente dhe elastike, me trashësi 1,9 – 2 mm. Ai duhet të lyhet me solucion kundra ujit. Kartoni thith lagështirën, thahet shpejt dhe mbron kaviljen nga dëmtimet e mundshme.

Kamareta prej çeliku. Tabanit, në pjesën e thembrës nga poshtë i vendoset një kamaretë (shirit çeliku) të kanalizuar me nervaturë me gjatësi 14 – 15 cm dhe gjerësi 8 – 10 mm. Shiriti i çelikut vendoset nga fundi i thembrës në gjatësi nga 2,8 deri 3 cm larg qendrës së thembrës (pjesa e rrumbullakët) në brendësi.

Kamareta e çelikut mbulohet me karton fibër të presuar, të përmasave 14 – 15 cm gjatësi dhe 6,4 – 6,5 cm gjerësi, sipas formës së tabanit.

Sfungjeri- Në vend të thembrës, në këpucë duhet vendosur një shollë e vogël prej sfungjeri anatomike (memory foam) me trashësi 11 mm i realizuar me një shtresë të poshtme me gomë —formëzall, duke i shtuar një shtresë të sipërme lëkure të cilësisë së mire me trashësi 0.9 mm. Paraqet gjithashtu ndërfaqje të brendshme prej sfungjeri, që garanton standarde të larta përsa i përket shkëlqes si tek thembra (Amortizimi) ashtu edhe në qendër të shollës për të patur një komfort të madh gjatë përdorimit.

PJESA E POSHTME E KËPUCËS

DETAJET, LLOJI I MATERIALIT DHE PUNIMI

SHOJE GOME

Pjesa e poshtme e këmbës është ndërtuar me sistemin hark, për të ruajtur qëndrimin natyror të këmbës me lëvizje dinamike, sistemi i tabanit AS dhe përkulshmërisë MSL. Nëpërmjet ngjitësëve të përshtashëm duhet të montohen në shollë, shtroja, me astarin dhe duke vazhduar me pas me tegelin qepës —*blakel*.

Sholla duhet të realizohet monoblok, prej materiali gome PU (Poliuretan) me ngjyrë të zezë dhe karakterizohet nga një dizenjim i veçantë me relief me dhëmbëza në funksion të rezistencës në fërkim. Sholla duhet të bashkohet me tabanin nëpërmjet ngjitjes. Sholla përbëhet nga një trup i vetëm dhe ndarja në shtresa e gomës së takës, nuk lejohet. Rifinitura e shollës në gomë vjen përmes frezimit të kujdesshëm të pjesëve shtesë.

Taka prej gome ka lartësi rreth 3.5 cm. Pjesa e poshtme e shollës përfundon me një dizenjim me vijëzime me dimensione të ndryshme për funksion anti rrëshqitës. Goma duhet të jetë e përshtatshme për gjithë kohën e përdorimit. Ajo nuk duhet të krijojë probleme, nuk duhet të shtypet apo të konsumohet si nga ana e brendshme ashtu dhe nga ana e jashtme.

Për shollën e femrave do të përdoret një shollë e ngjashme me atë të meshkujve që i përshtatet materialit, modelit, masës, formës dhe karakteristikave në cilësi.

Poshtë shollës, në pjesën e harkuar të saj (në hapësirën që krijohet mes takës dhe pjesës së përparme) vendoset numri përkatës i këpucës. Numri është i rrethuar nga një vizë e lehtë. Ky numër vendoset me gdhendje për çdo këpucë dhe shënohet në anën e

brendshme të shputës.

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.

Këpucët duhet të jenë të qepura mirë, të jenë të buta, të lehta, të jenë të rehatshme në përdorim dhe të duken të rregullta kur të vishen nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

Këpucët duhet të jenë të lehta për tu mirëmbajtur.

Lëkura quhet e cilësisë së parë kur ka të përpunueshme jo më pak se 92% të sipërfaqes. Tek lëkura defektet lejohen deri në 4% të sipërfaqes, nga të cilat jo më shumë se 2 % në kurriz (krupon).

Lëkura për faqe këpucësh duhet të jetë:

- o e butë dhe e vajosur mirë,
- o e ngjeshur dhe kompakte,
- o e pastruar nga ana e mishit
- o e mbushur dhe e regjur shumë mirë
- o e shtrirë mirë në të gjithë sipërfaqen,
- o e barazuar dhe të zmeriluara

Lëkura për faqe këpucësh duhet të ketë:

- o rezistencë maksimale ndaj njollave, ujit dhe nxehtësisë,
- o ngjyrosje uniforme dhe të qëndrueshme në të gjithë sipërfaqen,
- o formë të rregullt.

Lëkura nuk duhet të egërsohet mbas lagies dhe montimit.

Lëkura duhet t'i rezistojë tërheqjes dhe të mos çahet gjatë qepjes.

Lëkura e këpucës duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.

Lëkura duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përshkueshmërisë së ujit dhe të sigurojë ajërim të mirë të këmbës.

Lëkura duhet të ketë rezistentë maksimale ndaj vajrave, agjentëve kimikë si dhe të jetë lëkurë reflektuese ndaj diellit.

Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj rrezatimit Ultraviolet.

Tekstili duhet të ketë veti hidrofobike.

Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.

Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përshkueshmërisë së erës dhe ujit dhe të sigurojë ajërim të mirë të trupit.

Shojet e gomës, cilësia e parë, nuk duhet të bien në kontakt me vajra, lëndë kimike, benzinë dhe tretësira të tjerë organikë si dhe me pajisje ngrohëse.

Shojet duhet të presohen me kujdes që të mos lindin vende të pambushura ose të çara.

Shojet nuk duhet të kenë rrjedhje nga procesi i vullkanizimit, diferencë në trashësi, gropa, gunga, sipërfaqe jo të lëmuar dhe lulëzim të squfurit.

Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.

- o Tegelat e qepjes së këpucëve duhet të jenë me hap 3- 4 shpime në 1 cm.
- o Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
- o Tegelat duhet të jenë të fortë dhe qëndrueshmëria duhet të jetë mbi 9 kg.
- o Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- o Tegelat qepës duhet të jenë me termosaldim.
- o Nuk lejohet çarje nga gjilpëra dhe prishje tegeli.
- Të gjithë elementët e këpucës duhet të jenë simetrikë.
- Artikulli duhet të prodhohet sipas përmasave që do të dalin nga procesi i matjeve të të gjithë personelit të *efektivit te Gardes qe do ti perdor ato*
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e këpucëve është $\pm 2\%$.
- Lëkura, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues.
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001 – 2008.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Secila palë e këpucëve duhet të pajisen me etiketa prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa dhe përbërja. Etiketa duhet të qepet në astarin e brendshëm të lapetës. Masa e këpucëve, duhet të vendoset dhe poshtë shojeve të gomës në mënyrë të dukshme. Në momentin e dorëzimit këpucët duhet të jenë të lyera me bojë, të pastëra dhe të rregullta. Paketimi i këpucës duhet të bëhet në kuti të vogla kartoni sipas masës dhe gjinisë. Në secilën kuti do të futen një palë këpucë dhe një qesë e vogël me silikon. Të gjitha kutitë e vogla të të njëjtës masë do të vendosen në kuti kartoni të mëdha. Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

TRANSPORTI

Kutitë me secilin artikull të paketuar më vete duhet të transportohen nga prodhuesi deri tek njësitë shpenzuese të ambienteve të Gardes. Transporti mund të bëhet me çdo lloj mjeti që garanton transport të sigurt të produktit.

Kujdes! Artikujt konsiderohen teknikisht të pranuar vetëm kur plotësojnë të gjitha kërkesat e Specifikimeve Teknike.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i

veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti II: “Blerje Këpucë për Gardën e Republikës”			
Nr	Emertimi	Njësia matëse	Sasia e pritshme
1	Këpucë Gjysma Uniforme Vere	palë	550
2	Këpucë Gjysma Uniforme Dimri	palë	550
3	Këpucë me qafa stërvitje Vere	palë	450
4	Këpucë me qafa stërvitje Dimri	palë	450
5	Këpucë tip atlete	palë	20
6	Atlete Sporti	palë	200

Afati e lëvrim:

Brenda 90(nënëtdhjetë) ditëve nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.

Shtojca 13

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
----------	-------

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|----------|-------|
| 1. _____ | _____ |
|----------|-------|

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrime” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

